



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

05-10-2012

Plani - Projekti - Titulli			
Nr. i organit Org. broj	01-013/1395	Shitja e Prilog	Vlera Vrednost



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë

Opština Vitina

Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja d), 82.3 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L -040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28/2008) dhe nenit 36 paragrafi 2 shkronja d) e Statutit të Komunës së Vitisë, nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011 dhe kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për rishqyrtimin e Vendimit 01-013/1395 të datës 09.08.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur me 03 tetor 2012 aprovon këtë:

V E N D I M

PER SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 01-13/1395 TË DATËS 09.08.2011

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë SHFUQIZON Vendimin për kufizimin e ofrimit të shërbimeve të caktuara komunale dhe kushtëzimin e ofrimit të këtyre shërbimeve me pagimin e faturave për mbeturina dhe ujë me nr.01-13/1395 të datës 09.08.2011.

Neni 2

Shfuqizimi i vendimit nga neni 1 i këtij vendimi bëhet në bazë të shqetësimeve të qytetarëve të Komunës së Vitisë dhe të rekomandimit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës se një kushtëzim i tillë i ofrimit të shërbimeve nuk është në pajtim me dispozitat ligjore dhe është në kundërshtim me të drejtat dhe lirit e njeriut.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë dhe drejtorit tjera të organit të administratës të Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Vendimi për kufizimin e ofrimit të shërbimeve të caktuara komunale dhe kushtëzimin e ofrimit të këtyre shërbimeve me pagimin e faturave për mbeturina dhe ujë, nuk prodhon efektet juridike

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

KRYESUESI I KUVENDI

Skenderbe Hebib

